

# SBASHK Arsimimi sot

Janar, 2026

Gazeta elektronike

## SBASHK pjesë e Konferencës Përmblyëse të ETUCE–EFEE në Kishinau, Moldavi



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka marrë pjesë në Konferencën Përmblyëse të përbashkët ETUCE–EFEE, e cila është mbajtur më 28–29 janar 2026 në Kishinau, Moldavi... (faqe 4)

Presim të jetë një vit i mbarë



Ikën ditë e muaj dhe në Kosovë vazhdojnë të mungojnë institucionet, që do të duhej të formoheshin ... (faqe 2)

**NSKAP në Shtërpcë realizon anëtarëime të reja, ballafaqohet me mungesë të kushteve të punës**



Niveli Sindikal Komunal i Arsimit në Shtërpcë ka filluar me organizimin e shumë aktiviteteve për... (faqe 3)

## SBASHK pritet nga drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MASHTI



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarja për trajnime dhe informim, Drita Vitia Zeneli, ishin... (faqe 5)

## Zgjedhjet Sindikale në Vushtri, u rizgjodh kryetar Kadri Hyseni ndërsa nënkryetare Teutë Dërguti



Kuvendi i NSKAP-it të Vushtrisë i propozoi Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e z. Blendor Shatri për Kryetar të SBASHK-ut, ndërsa propozoi që ... (faqe 5)

## Editorial

### Presim të jetë një vit i mbarë



Ikën ditë e muaj dhe në Kosovë vazhdojnë të mungojnë institucionet, që do të duhej të formoheshin në bazë të besimit të qytetarëve shprehur me votën e lirë të tyre. Pas shumë e shumë lojërash të partisë që doli e para në zgjedhjet e 9 shkurtit, nuk u krijuan institucionet, por u vendos të shkohej prapë në zgjedhje duke humbur kështu ditë e muaj deri në zgjedhjet e 28 dhjetorit, por edhe ato na dolën me telashe dhe me nevojën e rinumërimit të votave për deputetë. Kjo ka bërë që edhe pas dy palë zgjedhjesh ende të mos kemi institucione. Kjo vonesë ka ngritur shumë dilema e pikëpyetje e ndër to është edhe ajo se çfarë do të ndodhë nëse do të vazhdohet me mungesë institucionesh dhe nuk ka se si e kush ta votojë Ligjin për buxhet për vitin 2026 dhe kështu të krijohet edhe një problem i madh që nëse nuk dalin pagat. Ky do të ishte problem i madh dhe do të krijohet edhe më shumë pakënaqësi. Kjo

pakënaqësi është e kuptueshme dhe urojmë të mos ndodh sepse shumica e punëtorëve në sektorin e arsimit por edhe atyre në polici e sektorë të tjerë varën nga këto paga e aq më keq janë edhe në kredi dhe mund të kenë telashe edhe e bankat. SBASHK –u uron që partia që doli e para dhe partitë të tjera të veprojnë ashtu si duhet dhe të krijohen institucionet në mënyrë që të gjendet rrugëdalje edhe për Ligjin e pagave se e kundërta do të krijonte shumë pakënaqësi dhe SBASHK-u pastaj do ta analizojë situatën dhe kërkesat e anëtarësisë dhe në Këshillin Drejtues do të merren vendime për angazhime e veprime ashtu si kërkon anëtarësia. Urojmë dhe presim që viti 2026 të jetë më i mbarë, por populli e ka thënë se dita e mirë shihet në mëngjes. E janari nuk solli asgjë të mirë, po solli shumë sfida e shqetësime dhe mungesë të institucioneve.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel: +383 (0) 38 226 940



## Bashkëbisedim

### NSKAP në Shtërpçë realizon anëtarëime të reja, ballafaqohet me mungesë të kushteve të punës



Niveli Sindikal Komunal i Arsimit në Shtërpçë ka filluar me organizimin e shumë aktiviteteve për mësimdhënës, duke përfshirë rëndësinë dhe rolin e SBASHK-ut. Tash e gjashtë muaj në

këtë komunë është zgjedhë kryetari i ri i Nivelit Sindikal Komunal të Shtërpçës (NSKAP), Avni Shabani, i cili brenda pak muajve e ka rikthyer një numër të madh të anëtarësisë përmes platformës e-Kosova.

Në numrin e janarit të revistës “Arsimimi Sot”, SBASHK ka realizuar një intervistë me kryetarin e kësaj komune, Avni Shabani, i cili ka treguar më shumë rreth kushteve të punës së mësimdhënësve në këtë komunë dhe synimeve të tij si kryetar i Nivelit Sindikal Komunal.

**SBASHK:** Tash kur kanë kaluar mbi 6 muaj prej kur e keni marrë pozitën e kryetarit të NSKAP-it të Shtërpçës, cilat janë aktivitetet të cilat i keni zhvilluar?

**Shabani:** Gjatë më shumë se gjashtë muajve në pozitën e kryetarit të NSKAP-it në Shtërpçë, kemi realizuar anëtarëime të reja, ku mësimdhënësit janë njoftuar me rolin dhe rëndësinë e SBASHK-ut. Po ashtu, disa mësimdhënës që kishin qenë më herët anëtarë janë rikthyer në SBASHK dhe janë regjistruar përmes platformës e-Kosova.

**SBASHK:** Cilat janë synimet e juaja në këtë pozitë për të cilën edhe jeni zgjedhur?

**Shabani:** Synimi im kryesor në këtë pozitë është mbrojtja e të drejtave të mësimdhënësve, forcimi i zërit sindikal në komunën e Shtërpçës, rritja e transparencës dhe bashkëpunimit me institucionet relevante, si dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

**SBASHK:** Me çka ballafaqohen mësimdhënësit e Shtërpçës sa i përket kushteve të mësimin, e të cilat duan ndryshim ose përmirësim?

**Shabani:** Mësimdhënësit në Shtërpçë përballen me sfida të ndryshme, veçanërisht sa i përket kushteve fizike në shkolla, ngrohjes, pajisjeve mësimore dhe mjeteve didaktike. Këto janë fusha që kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësim të vazhdueshëm.

**SBASHK:** Shabani: Cilat janë kërkesat kryesore të mësimdhënësve të Shtërpçës?

**Shabani:** Kërkesat kryesore të mësimdhënësve lidhen me përmirësimin e kushteve të punës, sigurinë në vendin e punës, furnizimin me ngrohje adekuate, si dhe mundësitë për zhvillim profesional. Në këtë drejtim, kemi bërë kërkesë zyrtare në SBASHK për mbajtjen e trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Trajnimi është konfirmuar nga SBASHK-u, mirëpo ne si shkolla kemi kërkuar shtyrjen e tij për shkak të mungesës së druve për ngrohje, në mënyrë që të mos ketë shpenzime shtesë gjatë vikendeve.

**SBASHK:** Sa shkolla ka Shtërpça dhe sa anëtarë numëron SBASHK-u në këtë komunë?

**Shabani:** Në komunën e Shtërpçës janë katër shkolla që punojnë sipas planprogramit të Republikës së Kosovës, me paralele të ndara. SBASHK-u në këtë komunë numëron gjithsej 62 anëtarë aktivë, ndërsa edhe 4 mësimdhënës të tjerë kanë aplikuar, por ende nuk janë përfshirë në listën e pagave.

**SBASHK:** Sa ka kërkesa për të ndjekur trajnimet të cilat i organizon SBASHK-u e që mësimdhënësve u shërbejnë për zhvillim profesional?

**Shabani:** Kërkesat për ndjekjen e trajnimeve që organizohen nga SBASHK-u janë të vazhdueshme dhe mësimdhënësit shprehin interesim të madh për to. Siç është cekur edhe në pyetjen e katërt, ne kemi adresuar kërkesën për mbajtjen e trajnimeve dhe mbesim të përkushtuar që, sapo të krijohen kushtet e përshtatshme, ato të realizohen për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

SBASHK vazhdon mbështetjen e mësimdhënësve përmes trajnimeve profesionale në të gjitha komunat e Kosovës.

## Gjatë muajit

### SBASHK pjesë e Konferencës Përmblylëse të ETUCE–EFEE në Kishinau, Moldavi



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka marrë pjesë në Konferencën Përmblylëse të përbashkët ETUCE–EFEE, e cila është mbajtur më 28–29 janar 2026 në Kishinau, Moldavi, me temën: “Partnerët Socialë Sektorialë Evropianë në Arsim – Promovimi i përfshirjes së personave me nevoja të veçanta në arsim”.



SBASHK në këtë konferencë ishte përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, dhe Nënkryetarja, znj. Vjollca Shala, duke kontribuar në diskutimet evropiane mbi politikat gjithëpërfshirëse në arsim dhe rolin e dialogut social në avancimin e të drejtave të nxënësve dhe mësimit.

Konferenca dyditore ishte organizuar në kuadër të projektit të dialogut social “InclEdu4AllNeeds”, i cili synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet partnerëve socialë në sektorin e arsimit për të garantuar përfshirje efektive të personave me nevoja të veçanta në sistemet arsimore.

Gjatë konferencës ishin prezantuar rezultatet e studimit kërkimor dhe seminareve trajnuese të realizuara në kuadër të projektit, si dhe ishin diskutuar hapat e mëtejme për veprim në kuadër të Dialogut Social Sektorial Evropian në Arsim (ESSDE). Një rëndësi e veçantë i ishte kushtuar vlerësimit të Draft-Udhëzimeve të Përbashkëta për promovimin e përfshirjes efektive përmes nismave të përbashkëta të partnerëve socialë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Pjesëmarrësit ishin njoftuar gjithashtu me praktikat më të mira evropiane, të mbledhura gjatë seminareve trajnuese dhe aktiviteteve kërkimore, të cilat kishin shërbyer si modele konkrete për ndërtimin e politikave gjithëpërfshirëse në arsim.

SBASHK vazhdon të mbetet e përkushtuar në avancimin e arsimit gjithëpërfshirës, mbrojtjen e të drejtave të mësimit dhe nxënësve, si dhe në forcimin e rolit të sindikatave në proceset vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe evropian.



SBASHK pritet nga drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MASHTI

## Përfaqësuesit e SBASHK-ut u pritën gjatë muajit janar nga drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MASHTI



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarja për trajnime dhe informim, Drita Vitia Zeneli, ishin pritur nga drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MASHTI, Anita Kadriu, të hënën e 19 janarit 2026, ku i pranishëm ishte edhe Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Zhvillimit Profesional dhe Licencimit të Punonjësve Arsimit, Osman Beka.

Në këtë takim kryetari Jasharaj e kishte uruar drejtoreshën Kadriu për emërimin në këtë pozitë duke i ofruar bashkëpunimin e Sindikatës dhe anëtarësisë në rritjen dhe zhvillimin e cilësisë në gjithë sistemin arsimor në vend. Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri e kishte njoftuar zonjën Kadriu për zhvillimin e trajnimeve për mësimdhënës, të cilat SBASHK aktualisht po i mban në dy programe: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, të cilat janë të licencuara nga MASHTI.



Ymeri kishte thënë se të gjitha trajnimet që SBASHK-u i organizon, e mësimdhënësve u shërbejnë sado pak të përfitojnë njohuri të reja, i mbulojnë me mjete vetanake, pra nga mjetet që grumbullohen nga anëtarësia, derisa ishte shprehur i gatshëm që të bashkëpunojë me MASHTI-n për rritjen e cilësisë në arsim edhe përmes organizimit të trajnimeve edhe në programe tjera. Ymeri kishte shprehur shqetësim rreth nënshkrimit të Kontratës kolektive si dhe rritjen e koeficientit të pagave për stafin arsimor. Nga ana e saj, zonja Kadriu kishte kërkuar të njihet me shqetësimet e mësimdhënësve dhe stafit tjetër arsimor, të cilin e përfaqëson SBASHK-u.

Zgjedhjet Sindikale në Vushtrri

## Është rizgjedhur kryetar Kadri Hyseni, ndërsa nënkryetare Teutë Dërguti



Të enjten, më 29 janar 2026, në Vushtrri është mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku ishin zgjedhur kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Vushtrrisë, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

vGjatë procesit zgjedhor në Vushtrri ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rahman Jasharaj dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Vushtrri u zhvillua në mënyrë të

rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Vushtrrisë ishte rizgjedhur Kadri Hyseni, ndërsa nënkryetare, Teutë Dërguti.



Kuvendi i NSKAP-it të Vushtrrisë i kishte propozuar Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e z. Blendor Shatri për Kryetar të SBASHK-ut, ndërsa propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

## SBASHK është pritur nga kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi

SBASHK ka filluar takimet me kryetarët e rinj të zgjedhur të Komunave të Kosovës, ku të enjten e 23 janarit kishte takuar kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi.



SBASHK-u i udhëhequr nga kryetari, Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, zyrtari Ligjor, Blendor Shatri dhe kryetari i Nivelit Sindikal Komunal të Vushtrrisë, Kadri Hyseni, ishin pritur nga kryetari i Komunës, Ferit Idrizi dhe drejtoresha e Arsimit në këtë Komunë, Naile Bekteshi.



Ky kuvend ishte organizuar në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.

Kryetari Jasharaj i kishte shprehur urimet e përzemërta kryetarit të Komunës, Ferit Idrizi, të cilit i kishte uruar suksese në punë, sidomos në angazhimin e tij për përmirësimin e kushteve të arsimit për mësimdhënës dhe nxënësit e komunës.



Në këtë takim ishin diskutuar çështje të ndryshme që lidhen me arsimin dhe rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të SBASHK-ut me Komunën e Vushtrrisë.

Jasharaj e kishte përgëzuar Idrizin me rastin e marrjes së mandatit të dytë në krye të Komunës dhe i kishte uruar suksese si dhe drejtoreshës së re të Arsimit në këtë Komunë, Naile Bekteshi.

Kryetari Rahman Jasharaj e kishte pranur një dhuratë simbolike nga kryetari Ferit Idrizi, i cili e kishte falënderuar Jasharajn për urimet dhe vlerësimin e ndërsjellë.

## Trajnime

### Në janar SBASHK i përfundoi tri grupe të trajnimit dhe i filloi pesë të reja

Edhe viti 2026 në SBASHK filloi me organizimin e shumë grupeve të trajnimit për mësimdhënës në dy programe të trajnimit: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.

Të shtunën e 31 janarit SBASHK filloi me katër grupe të reja të trajnimit në këto programe në komunën e Dragashit dhe të Fushë-Kosovës.

Me tri grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 1 dhe moduli 2, të shtunën filloi Dragashi, ku grupi i trajnimit në modulën e parë po udhëhiqet nga trajneri Vloran Krasniqi derisa grupet e modulit të dytë po udhëhiqen nga trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Arton Ajeti, respektivisht Admir Halimi.

Ndërkohë, të shtunën filloi edhe një grup i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në Fushë-Kosovë, i cili po udhëhiqet nga trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Jehona Hysenaj.

Paraprakisht, SBASHK kishte filluar me katër grupe të trajnimit në Shtime dhe dy në Kamenicë.



Të shtunën e 24 janarit SBASHK kishte organizuar me sukses edhe gjashtë grupe tjera të trajnimit, ku dy grupe të trajnimit kishin filluar në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Arben Zymeri dhe Dorentinë Demaku.



Gjatë këtij vikendi kishte filluar edhe një grup i trajnimit në po të njëjtin program në modulën e parë, me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Blerona Ahmeti si dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner, Emrush Ahmeti.



Mësimdhënësit pjesëmarrës në këto trajnime I kishte vizituar sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, i shoqëruar nga zyrtari Ligjor Blendor Shatri dhe kryetari i NSKAP-it për Shtime, Bekim Krasniqi.



Ata kishin bashkëbiseduar me pjesëmarrësit rreth rëndësisë së trajnimeve dhe çështjeve të tjera që lidhen me mësimdhënien. Sekretari i Përgjithshëm i kishte përgëzuar mësimdhënësit për përkushtimin e tyre, duke theksuar se edhe në ditët e vikendit dhe përkundër kushteve jo të favorshme për zhvillimin e trajnimeve (mungesës së nxemjes në objekt), ata po trgeojnë vullnet dhe gatishmëri për të fituar njohuri të reja në funksion të ngritjes profesionale.



Kurse në Kamenicë, gjatë vikendit të 24 dhe 25 janarit kishte filluar me dy gurpe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” moduli i parë, ku njëri grup kishte filluar të shtunën dhe tjetri të dielën.



Trajnimet në Kamenicë janë udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Xhemail Kastrati. Mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Kamenicë, Lulzim Thaqi, i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit. Ndërkohë një javë më parë në Gjilan kishte filluar një grup i trajnimit në Gjilan, në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”- moduli 2, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Musli Neziri.



Mësimdhënësit që e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti, derisa në këtë komunë e kishte vazhduar trajnimin edhe grupi tjetër i mësimdhënësve të cilët e kishin filluar trajnimin javë më parë, me trajneren Ibadete Limani.



Gjatë janarit SBASHK kishte organizuar edhe testet për disa grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” moduli 1 dhe 2, ku në Mitrovicë ishte organizuar testi për një grup të mësimdhënësve, nën administrimin e nënkryetares së SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretarit të Përgjithshëm, Ymer Ymeri.



Gjatë testimit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli, i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e procesit.



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fevzi Selmani dhe ishte mbajtur në shkollën “Hasan Prishtina” në Mitrovicë.



Ndërsa, në Prizren SBASHK kishte organizuar testet për dy grupe të mësimeve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli 1 dhe moduli 2, dhe ishin udhëhequr nga trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Naser Kastrati, respektivisht Ermal Ahmetaj.



Testet ishin administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe trajnerja Dorentinë Demaku.



Ndërsa, për tu kujdesur për mbarëvajtjen e testit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Prizren, Reshit Kushaj. Gjatë këtij vikendi SBASHK kishte organizuar testet edhe në Rahovec dhe Gjakovë nën udhëheqjen e zyrtarit Ligjor, Blendor Shatri.




Në Rahovec trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri Emin Hoxha, kurse i pranishëm për tu kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu dhe ish kryetari, Veli Morina.



Kurse në Gjakovë trajnimi ishte udhëhequr nga trajnerja Litvana Spahija.


## REAGIM I SINDIKATËS SË BASHKUAR TË ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS (SBASHK) lidhur me ligjëratën e mbajtur në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë nga përfaqësues të Gjykatës Speciale dhe YIHR



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) shpreh shqetësimin e thellë dhe kundërshtimin e fuqishëm ndaj mbajtjes së ligjëratës në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, e realizuar nga përfaqësues të Gjykatës Speciale në bashkëpunim me organizatën Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR). SBASHK e konsideron të papranueshme që institucionet arsimore të shfrytëzohen për promovimin e një narrative të njëanshme, me synimin që nxënësit të binden se Gjykata Speciale përfaqëson drejtësi. Nuk ka padrejtësi më të madhe sesa fakti që për më shumë se pesë vite mbahen në paraburgim luftëtarët e lirisë, bashkëpunëtorë të NATO-s, të cilët luftuan për të drejtat elementare të popullit të Kosovës – për lirinë, dinjitetin dhe të drejtën për arsimim. Është e pamohueshme se gjatë viteve të represionit serb, Serbia kishte mbyllur të gjitha shkollat shqipe në Kosovë, përfshirë edhe Gjimnazin “Xhevdet Doda”. Pikërisht në atë periudhë të errët, mësimdhënësit dhe punëtorët e arsimit, të organizuar edhe përmes SBASHK-ut, mbajtën gjallë arsimin shqip me sakrificat e jashtëzakonshme. Prandaj, është paradoksale, e padrejtë dhe moralisht e papranueshme që sot, në po ato ambiente shkollore, të promovohet një gjykatë që po gjykon njëanshëm luftën çlirimtare të popullit të Kosovës, duke e barazuar viktimitën me agresorin. SBASHK reagon gjithashtu edhe

ndaj përfshirjes së organizatës Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR), e cila përmes këtij aktiviteti ka kontribuar në futjen e një agjende politike dhe ideologjike në institucionet arsimore, pa respektuar ndjeshmërinë historike, kombëtare dhe arsimore të shoqërisë sonë. U bëjmë thirrje organeve përgjegjëse – Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë dhe menaxhmentit të Gjimnazit “Xhevdet Doda” – që të marrin masa konkrete lidhur me këtë rast dhe të mos lejojnë që shkollat të shndërrohen në hapësira për promovimin e mekanizmave që cenojnë të vërtetën historike dhe dinjitetin e luftës sonë çlirimtare. Njëkohësisht, SBASHK apelon te të gjithë anëtarët tanë, punëtorët e arsimit në Kosovë, që të tregojnë vigjilencë dhe përgjegjësi profesionale e kombëtare, duke mos lejuar organizimin e aktiviteteve të tilla në institucionet tona arsimore. Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës riafirmon qëndrimin e saj të palëkundur në mbrojtje të vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në përkrahje të drejtuesve institucionalë të asaj lufte – Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi – të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë, vetëm pse ishin në anën e drejtë të historisë. Liria e Kosovës nuk është krim. Lufta për arsim, liri dhe dinjitet nuk gjykohet.

## SBASHK kishte kërkuar siguri në shkolla pas vërshimeve të janarit



Me përgatitjet për rifillimin e mësimit në gjysmëvjetorin e dytë në Kosovë, disa komuna ishin vërshuar nga reshjet e shiut, ku ishin rrezikuar edhe nxënësit dhe mësimdhënësit nëpër shkolla. Me këtë rast, SBASHK kishte reaguar duke kërkuar sigurinë e mësimdhënësve dhe nxënësve për rifillimin e mësimit.

“Reshjet e shumta të shiut dhe përmbytjet e ditëve të fundit kanë krijuar rrezik serioz për sigurinë në shumë shkolla dhe për familjet e punëtorëve të arsimit. Kjo situatë ka dëshmuar edhe një herë se infrastruktura shkollore mbetet e pambrojtur dhe se reagimi institucional shpesh vjen vetëm pas presionit dhe shqetësimit publik. SBASHK përkrah vendimet e disa Drejtorive Komunale të Arsimit, si dhe vendimin e MASHTI-t për shtyrjen e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë deri më 12 janar 2026, duke vlerësuar se siguria e nxënësve dhe punëtorëve të arsimit duhet të jetë mbi çdo interes tjetër”, ishte thënë ndër të tjera në reagimin e SBASHK-ut.

## Kuvende zgjedhore të dy niveleve arsimore



Në ambientet e shkollës “Dardania” SBASHK-u ka mbajtur Kuvendin zgjedhor të Nivelit të Arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët. Në fjalën hyrëse kryetari i këtij Kuvendi Blerim Mehmetaj ka përshëndetur delegatet dhe delegatët dhe në emër të tyre ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala, sekretarin e përgjithshëm Ymer Ymeri.



Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut në fjalën përshëndetëse ka thënë se vitet e kaluara kanë qenë me plot sfida por ato i kemi tejkaluar falë unitetit dhe besimit të ndërsjellë. “Respekt për angazhimet e kryetarit Blerim Mehmeti, i cili në takimet e kryesisë dhe të Këshillit Drejtues ka prezantuar gjithë shqetësimet dhe kërkesat e të punësuarve në çerdhe dhe në institucionet tjera arsimore. Jam shumë i bindur se ky Kuvend do ta vërtetojë thënien bashkë e në SBASHK”, është shprehur Jasharaj.



Kontribut për rrjedhën e mbarë të këtij Kuvendi kanë dhënë edhe nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri duke u përgjigjur në pyetjet

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

pjesëmarrësve. Pas kësaj kryetari i këtij Kuvendi ka prezantuar raportin e punës 4 vjeçare. Në pjesën e dytë të këtij takimi pjesëmarrësit me vota unanime kanë rizgjedhur Blerim Mehmetin për kryetar e pastaj kanë zgjedhur me votën e fshehtë nënkryetaren Lutfie Ibrahimimi dhe anëtarët dhe anëtarët e Kryesisë së këtij Kuvendi.



Po të shtunë e 31 janarit në shkollën “Dardania” është mbajtur Kuvendi i Nivelit të Arsimit të Mesëm të Lartë. Fjalën hyrëse e ka prezantuar kryetarja Hanife Salihu, e cila ka folur për angazhimet e kryesisë dhe anëtarëve të Kuvendit në përpjekjet për të prezantuar në mënyrë të denjë zërin sindikal të këtij niveli arsimor. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj u është drejtuar me një fjalë përshëndetëse pjesëmarrësve në këtë Kuvend.



“Falënderoj që jeni pjesëmarrës në këtë ngjarje të rëndësishëm për sindikatën tonë. Vitet e kaluara kanë qenë me plot sfida por ato i kemi tejkaluar falë unitetit dhe besimit të ndërsjellë. Shpreh respekt për angazhimet e kryetares Hanife Salihu e cila në takimet e kryesisë dhe të Këshillit Drejtues ka prezantuar gjithë shqetësimet dhe kërkesat e të punësuarve në arsimin e mesëm të lartë”, ka thënë Jasharaj. Pas kësaj kryetarja Hanife Salihu ka prezantuar raportin e punës për 4 vitet e kaluara. Kontribut me vlerë edhe në këtë Kuvend kanë dhënë sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe nënkryetarja Vjollca Shala. Pas kësaj me vota unanime ky kuvend ka rizgjedhur për kryetare Hanife Salihun dhe pastaj edhe nënkryetarin Shpend Rexha dhe anëtarët e kryesisë.

